



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT  
KRYETARI

Nr. 1385 prot.

Tiranë, më 26 . 12 2023

URDHËR

Nr. 288, datë 26 . 12 . 2023

“Për pezullimin e afatit të zbardhjes së vendimeve gjatë periudhës së lejes vjetore”

Bazuar në nenin C, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 13, germa “c”, nenin 14, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenin 18 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për Organizimin dhe Funkionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në nenin 7, pika 1 të Rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, për shkak të lejes vjetore të gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

URDHËROJ:

1. Pezullimin e afatit të zbardhjes së vendimeve sipas nenit 24, pika 1 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, e ndryshuar, për periudhën nga data 26.12.2023 deri më datë 08.01.2024<sup>1</sup>, për çështjet e përfunduara në kuadër të Juridiksionit të Rivlerësimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
3. Një kopje e këtij urdhri t’i komunikohet Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI



Sokol Çomo

<sup>1</sup> Data 08.01.2024 përfshihet në afatet e pezullimit